



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 13.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Besa Security" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Besa Security" e datës 10.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 03.08.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 03.08.2020 ; Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Besa Security" me datë 10.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 13./08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Se pari ua perkujtoj se tenderi juaj është refuzuar në një rivleresim paraprak dhe atë refuzim nuk e keni kontestuar brenda afateve ligjore dhe kjo d.t.th.se ju nuk jeni me pale e interesit në këtë proces;

-Perkunder këtij fakti ju sqaroj se pretendimet tuaja nuk kanë baze ligjore, sepse në të gjitha rastet Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore dhe kërkesat e tenderit. Ju sqarojme shkurtimisht për të gjitha:

1. Asnjë parim nuk nënkupton se duhet të rekomandohet për dhenje të kontratës tenderuesi me çmimin me të ulët, por tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët;

2. Ne dosjen e tenderit dhe ne sqarimet para hapjes publike eshte sqaruar qarte se do te trajtohen tenderues te pergjegjshem vetem tenderuesit qe perfshijne ne çmimin e tyre te gjitha detyrimet financiare qe percaktohen me Ligjin e Punes;

3. Ua perkujtojmë se pos ketyre kerkesave me Vendimin e OSHP-se eshte rekomanduar qe te kerkohet interpretimi i KRPP-se lidhur me perpilimin e pagave de ne baze te atij interpretimi dhe kerkesave te Ligjit te Punes jane vleresuar te gjithë tenderet;

3. Lidhur me vleren e parashikuar per kete projekt jane dhene sqarimet para hapjes se tenderit dhe vlera e cila arrihet me shtimin ligjor prej 30% nuk nenkupton ne asnje rast qe te mbuloj periudhem maksimale te kohezgjatjes se kontrates prej 36 muajve, por mund te nderpritet ne momentin e arritjes se asaj vlere. Lidhur me kete i keni sqarimet e detajuara te dhene ne pergjegjen per tenderuesin tjeter qe ka parashtruar kerkese per rishqyrtim; dhe

-Lidhur me pretendimin per nderprerjen e aktivitetit te prokurimit me rastin e tejkalimit te vleres se parashikuar ju rekomandoj te lexoni me kujdes dispoziten qe e keni cekur: "Procedura e prokurimit pas marrjes se ofertave mund te anulohet per arsyen e meposhtme: (i) te gjithë tenderet e pergjegjshem permbajne çmime qe e tejkalojne buxhetin e AK-se". Pra eshte e tehne qarte se procedura mund te anulohet e jo duhet te anulohet, qe d.t.th. se eshte e drejte e AK-se te vendos lidhur me kete.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit